

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: POLICIA E KOSOVËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Numri i Prokurimit	214/30400-26-1946-5-1-1
--------------------	-------------------------

Sa i përket tenderit për: “NDËRTIMI I STACIONIT POLICOR VERI NË PRISHTINË”

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Emri i Kompanisë: “Olti Trasing” SH.P.K

Adresa : Rr.Bill Klinton pn. 10 000 Prishtinë

Numri Telefonit: 045-500-535

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: Arjant Topanica

Adresa elektronike: prokurimi.oltitrasing@gmail.com

Data e parashtrimit të ankesës:09.09.2026

Nënshkrimi dhe vula:



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. B05- Njoftimi për kontrate: 13.04.2026
2. B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara: 27.04.2026
3. B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara: 11.05.2026
4. B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara: 21.05.2026
5. Dosja e Tenderit: 08.04.2026
6. Dosja e Tenderit: 24.04.2026
7. Dosja e Tenderit: 08.05.2026
8. Dosja e Tenderit: 20.05.2026
9. Afati për dorëzim të tenderit: 02.06.2026
10. Kërkesë për Rishqyrtim ne kriteret e DT: Nuk ka date të shënuar ne Vendim e AK kur është dorëzuar Kërkesa për Rishqyrtim.
11. Vendim për Pezullim të aktivitetit të prokurimit:16.04.2026
12. Vendim për aprovim të pjesshëm e Kërkesës për Rishqyrtim: 24.04.2026
13. Kërkesë për Rishqyrtim në kriteret e DT: Nuk ka date të shënuar ne Vendim e AK kur është dorëzuar Kërkesa për Rishqyrtim.
14. Vendim për Pezullim të aktivitetit të prokurimit:30.04.2026
15. Vendim për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim: 05.05.2026
16. Kërkesë për Rishqyrtim ne kriteret e DT: Nuk ka da te të shënuar ne Vendim e AK kur

është dorëzuar Kërkesa për Rishqyrtim.

17. Vendim për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim:20.05.2026

18. Ankesa në OSHP nr.354/26: 02.06.2026

19. Procesverbal i Hapjes së Tenderëve:02.06.2026

20. Vendimi i OSHP-se- PSH.NR 354/26- 08.06.2026

21. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues:18.08.2026

22. Kërkese për Rishqyrtim Olti Trasing SH.P.K: 24.08.2026

23. Vendim mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit:25.08.2026

24. Vendimi i AK - Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 31.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					Jo	X	
----	--	--	--	--	----	---	--

Hapja e ofertave është bere në mënyre elektronike me datën 02.06.2026 në ora 14:00

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X				Jo		
----	---	--	--	--	----	--	--

Autoriteti Kontraktues – **Policia e Kosovës**, me datën **18.08.2026** në platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka rekomanduar që me kontrate të shpërblehet Grupi i OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K nga Suhareka. Formulari B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues është nënshkruar nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me datën **13.08.2026** (**5 dite para publikimit**) . Gjithashtu me datën **18.08.2026** ka publikuar edhe Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të kompanisë tone e cila ka te shënuar datën **11.08.2026**. (**8 dite para publikimit të Formularit B58**).

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po	X				Jo	
----	---	--	--	--	----	--

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën **24.08.2026** përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – **Policia e Kosovës**. Me datën **31.08.2026** përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin për refuzim të kërkesën ton për rishqyrtim si të pa bazuar nga Autoriteti Kontraktues- **Policia e Kosovës**.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 11 Informatat Sekrete Afariste

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Shkeljet e dispozitave - RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (RRPP 002/2024), janë:

Neni 7 - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion

Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues – **Policia e Kosovës**, me datën **18.08.2026** në platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka rekomanduar që me kontrate të shpërblehet Grupi i OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K nga Suhareka. Formulari B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues është nënshkruar nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me datën **13.08.2026 (5 dite para publikimit) .**

Gjithashtu me datën **18.08.2026** ka publikuar edhe Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të kompanisë tone e cila ka të shënuar datën **11.08.2026**. (**11 dite para nënshkrimit të Formularit B58** nga ana e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit).

Me datën **19.08.2026** përmes Platformës së E-prokurimit kemi bere kërkesë për qasje në dokumente e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues me datën **19.08.2026** na ka lejuar qasje të pjesshme në dokumentit e tenderit të Grupi i OE: **CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K** me arsyetimin së ky Grup i OE ka plotësuar Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit për Konfidencialitet.

Me datën **20.08.2026**, prape përmes platformës së e-prokurimit të Letrat Standarde kemi dërguar prape Kërkesë për të na lejuar qasje në dokumentet e tenderit të Grupit të OE: **CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K**, konkretisht të **ISO Certifikatat**. Në këtë kërkesë për qasje e kemi arsyetuar me fakte dhe argumente së **ISO Certifikatat** nuk mund të konsiderohen nga **AK konfidenciale**.

Edhe pse **AK** në platformën e e-prokurimit e kishte hapur (shikuar) kërkesën tone për qasje në dokumentet e tenderit Grupit të OE: **CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K- ISO Certifikatat**, **AK** nuk na ka kthyer asnjë përgjigjeje lidhur me kërkesën tone.

Kompania jone nuk është pajtuar me këtë qasje të Zyrtareve të **AK- Policisë së Kosovës** dhe Vendimin e Autoritetit Kontraktues që ka rekomanduar që me kontrate të shpërblehet Grupi i OE: **CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K** nga Suhareka në vlerë prej **2,020,202.00 €** që është **116,903.57 €** me çmim me të lartë së oferta e jone- Grupit të OE; **OLTI TRASING SH.P.K & UNICRON SH.P.K**. dhe me datën **24.08.2026** përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – **Policia e Kosovës**.

Me datën **31.08.2026** përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues- **Policia e Kosovës** për refuzim të kërkesën ton për rishqyrtim si të **pa bazuar**.

Pretendimet Ankimore lidhur me Ofertën e kompanisë tonë Grupi i OE: Olti Trasing SH.P.K: & UNICRON SH.P.K -

Pretendimi Ankimor 1 - Shkelje e nenit 1 paragrafi 2 dhe 3 të LPP

Autoriteti Kontraktues – **Policia e Kosovës** gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit konkretisht gjate fazës së vlerësimit të ofertave, eliminimit të ofertës tone dhe rekomandimin që me kontrate të shpërblehet Grupi i OE: **CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K** në vlerë prej **2,020,202.00 €** që është **116,903.57 €** me çmim me të lartë së oferta e jone- Grupit të OE; **OLTI TRASING SH.P.K & UNICRON SH.P.K**, ka bere shkelje substanciale të nenit 1 të LPP që është qëllimi i ligjit për faktin së:

- Ka dështuar të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve të Autoritetit Kontraktues, konkretisht të anëtareve të komisionit vlerësues të ofertave dhe Zyrtareve tjerë të AK që kane marre vendime lidhur me këtë aktivitet të prokurimit;
- Ka dështuar të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës për faktin së i ka konsideruar si konfidenciale dokumentet e tenderit të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K që e ka shpërblyer me kontrate dhe nuk na ka lejuar qasje të plote të ISO Certifikatave të dorëzuara nga ky grup i OE. Në dokumentet të cilat na i kane dhënë (ngarkuar) në CD e kane mbuluar me ngjyre të zeze që të mos duket numri i aktivitetit të prokurimit në Deklaratën nen Betim të Liderit të grupit, OE: CONSTRUMAX SH.P.K dhe Deklaratën nen Betim të anëtarit të grupit, OE: HARST Group SH.P.K. E kane mbuluar me ngjyre të zeze që të mos duket numri i aktivitetit të prokurimit në Marrëveshjen e Themelimit të Grupit dhe Aneksit Nr.3- dy Kërkesave për Konfidencialitet që ka dërguar ky grup i OE dhe shume dokumenteve tjera që ne konsiderojmë së këto veprime Zyrtaret Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues e kane bere me qellim të fshehjes së të dhënave të gabuara dhe mangësive që oferta e Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K, i ka ne ofertën e tyre dhe për të na vështirësuar përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim;
- Ka dështuar të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale të paanshme dhe etike për arsyet dhe veprimet e tyre të cilat i cekem me larte;
- Ka dështuar të ndjekin parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ku me kontrate kane shpërblyer Grupin e OE që kane dërguar oferte të pa përgjegjshme dhe qe ka çmimin për **116,903.57 €**

Arsyetimi i AK në Vendimin e datës 31.08.2026 për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim së gjeja GOE i rekomanduar së bashku me ofertën ka paraqitur kërkesën për trajtimin e dokumenteve përkatëse si sekret afarist, nuk qëndron për faktin së Operatoret Ekonomik edhe munde të kërkojnë që të konsiderohen sekret dokumentet ku në praktike ka raste kur OE kërkojnë që të gjitha dokumentet e ofertës të trajtohen si sekret, por është në përgjegjësinë e AK që të marre vendim konforme legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës së cilat dokumente mund të konsiderohen sekret.

Nuk mund të konsiderohen sekret afarist Certifikatat e ISO Standardeve, nuk mund të konsiderohet sekret afarist numri i aktivitetit të prokurimit i shënuar në Aneksin 2- Deklaratat nen Betim të Dosjes së Tenderit, nuk mund të konsiderohet sekret afarist numri i aktivitetit të prokurimit i shënuar në Aneksin 3- Kërkesë për Sekret Afarist të Dosjes së Tenderit , nuk mund të konsiderohet sekret afarist numri i prokurimit i shënuar në Aneksin – Deklarata për Themelim të Grupit.

Konstatimi i Zyrtareve të AK në Vendimin e datës 31.08.2026 për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim se gjeja nuk ka kufizuar qasjen së OE i janë paraqitur ISOT në pamje vizuale ne PC dhe

së AK i ka verifikuar dhe janë paraqitur sipas NJK dhe FDT-se, ne konsiderojmë së është konstatim jo profesional, diskriminues, jo transparent dhe tentim për fshehje të fakteve dhe provave. Prezantimi vizual i ISO Certifikatave nga Zyrtaret e AK pa dhënë asnjë mundësi të verifikimit të këtyre dokumenteve nga përfaqësuesja e kompanisë tone kur ka qene në qasje të dokumenteve, mos dërgimi i këtyre certifikatave pas kërkesës së dytë për qasje në këto ISO certifikata dhe informatave që kemi, ne konsiderojmë së Certifikata ISO 3834-3 2008 apo ISO 3834-3 2005 (për saldime) të cilën e ka dërguar së bashku me ofertën Grupi i OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K, nuk është valide për faktin së nuk është e lëshuar nga kompani e akredituar për lëshimin e këtyre ISO Certifikatave.

Prandaj bazuar ne të gjitha këto fakte dhe argumente që cekem me larte dëshmojnë së Zyrtaret e Autoritetit Kontraktues- Policisë së Kosovës gjate vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit kane bere shkelje esenciale të nenit 1 paragrafi 2 dhe 3 të LPP.

Përshkrim i nenit 1 paragrafi 2 dhe 3 i LPP

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.
3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Pretendimi ankimor nr.2 – Shkelje të nenit 6 të LPP

Autoritetit Kontraktues – Policia e Kosovës për realizimin e projektit “NDËRTIMI I STACIONIT POLICOR VERI NË PRISHTINË” e ka filluar që disa vite dhe është hera e trete që e ka publikuar por ende nuk ka arritur që ta përfundoj me sukses këtë aktivitet të prokurimit për shkak të shkeljeve të vazhdueshme ligjore që i ka bere gjate zhvillimit të tri here radhazi të aktivitetit të prokurimit për projektin - NDËRTIMI I STACIONIT POLICOR VERI NË PRISHTINË . Vonesat e një pas njëshme të shkaktuar (prej afër 5 viteve) me përfunduar me sukses këtë projekt është shkelje esenciale e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, konkretisht nenit 6 te LPP. Kjo dëshmon jo efikasitetin dhe efektivitetin e Zyrtareve Përgjegjës të

Autoritetit Kontraktues, ku për herën e parë Njoftimin për Kontrate e kanë publikuar me datën **02.12.2020**, dhe kanë dështuar që ta përfundojnë. Herën e dytë me **14.10.2022**, prapë kanë dështuar që ta përfundojnë dhe herën e tretë me **13.04.2026**. Bazuar në shkeljet që kanë bere gjate fazës para ofertuese duke përshtatur kriteret për OE të caktuar dhe duke kamufluar kritere siç është rasti me nënshkrimin dhe vulosjen nga të dy palët e Vendimeve për Inxhinieret dhe eliminimin e shtate ofertueseve tjerë, ne konsiderojmë së ky aktivitet i prokurimit prapë do të dështoj ashtu siç ka dështuar dy here radhazi gjate viteve paraprake.

Bazuar në faktet dhe argumentet e cekura me lartë shihet së AK-Policia e Kosovës gjate zhvillimit tri here radhazi nga viti 2020, ka bere shkelje esenciale të nenit 6 të LPP për faktin së gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka pasuar as efektivitet e as ekonomicitet.

Dëshmi: Të gjitha Njoftimet për Kontrate, Dosjet e Tenderit dhe dokumente tjera të shumta lidhur me këtë projekt duke filluar nga viti 2020 mund ti gjeni në Platformën e e-Prokurimit.

Pretendimi 3 - Shkelje e nenit 10 dhe 11 të LPP dhe nenit 7 të RRPP 002/2024

Siç e kemi cekur edhe me lartë me datën **19.08.2026** përmes Platformës së E-prokurimit kemi bere kërkesë për qasje në dokumente e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues me datën **19.08.2026** na ka lejuar qasje të pjesshme në dokumentit e tenderit të Grupit i OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K me arsyetimin së ky Grup i OE ka plotësuar Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit për Konfidencialitet.

Dëshmi: Kërkesa për qasje në Dokumentet e Tenderit e datës 19.08.2026

Me datën **20.08.2026**, përmes platformës së e-prokurimit të Letrat Standarde kemi dërguar prapë Kërkesë për të na lejuar qasje në dokumentet e tenderit të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K, konkretisht të ISO Certifikatat. Në këtë kërkesë për qasje e kemi arsyetuar me fakte dhe argumente së ISO Certifikatat nuk mund të konsiderohen nga AK konfidenciale.

Edhe pse AK në platformën e e-prokurimit e kishte hapur (shikuar) kërkesën tone për qasje në dokumentet e tenderit Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K- ISO Certifikatat, AK nuk na ka kthyer asnjë përgjigjeje lidhur me kërkesën tone

Dëshmi: Kërkesa e dytë për qasje në Dokumentet e Tenderit e datës 20.08.2026

Autoriteti Kontraktues - Policia e Kosovës në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik i ka konsideruar si konfidenciale dokumentet e tenderit të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K që e ka shpërblyer me kontrate dhe nuk na ka lejuar qasje të plote të ISO Certifikatave të dorëzuara nga ky grup i OE. Në dokumentet të cilat na i kanë dhënë (ngarkuar) në CD e kanë mbuluar me ngjyre të zeze që të mos duket numri i aktivitetit të prokurimit në Deklaratën nen Betim të Liderit të grupit, OE: CONSTRUMAX SH.P.K dhe Deklaratën nen Betim të anëtarit të grupit, OE: HARST Group SH.P.K. E kanë mbuluar me ngjyre të zeze që të mos duket numri i aktivitetit të prokurimit në Aneksin 7- Marrëveshjen e Themelimit të Grupit të OE dhe

Aneksit Nr.3- dy Kërkesave për Sekret Afarist që ka dërguar ky grup i OE dhe shume dokumenteve tjera që ne konsiderojmë së këto veprime Zyrtaret Përgjegjës të Autoritetit Kontraktues e kane bere me qellim të fshehjes së të dhënave të gabuara dhe mangësive që oferta e Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K, i ka ne ofertën e tyre dhe për të na vështirësuar përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim dhe Ankese për dërgim ne OSHP.

Siç e cekem edhe të pretendimi ankimor 1- Nuk mund të konsiderohen sekret afarist Certifikatat e ISO Standardeve, nuk mund të konsiderohet sekret afarist numri i aktivitetit të prokurimit i shënuar në Aneksin 2- Deklaratat nen Betim të Dosjes së Tenderit, nuk mund të konsiderohet sekret afarist numri i aktivitetit të prokurimit i shënuar në Aneksin 3- Kërkesë për Sekret Afarist të Dosjes së Tenderit , nuk mund të konsiderohet sekret afarist numri i prokurimit i shënuar në Aneksin – Deklarata për Themelim të Grupit.

Konstatimi i Zyrtareve të AK në Vendimin e datës 31.08.2026 për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim se gjeja nuk ka kufizuar qasjen së OE i janë paraqitur ISOT në pamje vizuale në PC dhe së AK i ka verifikuar dhe janë paraqitur sipas NJK dhe FDT-se, ne konsiderojmë së është konstatim jo profesional, diskriminues, jo transparent dhe tentim për fshehje të fakteve dhe provave. Prezantimi vizual i ISO Certifikatave nga Zyrtaret e AK pa dhëne asnjë mundësi të verifikimit të këtyre dokumenteve nga përfaqësuesja e kompanisë tone kur ka qene në qasje të dokumenteve, mos dërgimi i këtyre certifikatave pas kërkesës së dytë për qasje në këto ISO certifikata dhe informatave që kemi, ne konsiderojmë së ku veprim i Zyrtareve të AK-Policisë së Kosovës është në kundërshtim të plote me nenin 10 dhe 11 të LPP si dhe nenin 7 të RRPP 002/2024, për faktin së dokumente të cilat i cekem me larte nuk mund të konsiderohen si dokumente konfidenciale.

Dëshmi: - Deklarata nen Betim e Liderit të grupit, OE: CONSTRUMAX SH.P.K

Dëshmi: Deklarata nen Betim e anëtarit të grupit, OE: HARST Group SH.P.K

Dëshmi: Aneksit 3- Kërkesa për Sekret Afarist e Liderit të grupit, OE: CONSTRUMAX SH.P.K

Dëshmi: Aneksit 3- Kërkesa për Sekret Afarist e anëtarit të grupit, OE: HARST Group SH.P.K

Dëshmi: Aneksin 7- Marrëveshjen e Themelimit të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K

Pretendimi ankimor 4 - Shkelje nenit 59 të LPP dhe nenit 40 të RRPP Nr. 002/2024

Zyrtaret e AK – Policisë së Kosovës gjate fazës së vlerësimit të ofertës të Grupit të OE; OLTi TRASING SH.P.K & UNICRON SH.P kane bere shkelje esenciale të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik, konkretisht të nenit 59 të LPP dhe 40 të Rregullores Nr.002/2024 për faktin së na kane eliminuar pa drejtësisht nga aktiviteti i Prokurimit.

Eliminimi nga aktiviteti i prokurimit së gjeja Vendimet për Inxhinjerat nuk janë të vulosura nga të dy palët është konstatim jo profesional dhe tendencioz. Vendimet për Caktimin e Inxhinjereve janë të nënshkruara nga të dy palët dhe të vulosura nga kompania jone Lideri - Olti Trasing si subjekt

juridik. Inxhinieret janë persona fizik dhe për persona fizik është e mjaftueshme që vendimet të jene të nënshkruara e jo edhe të vulosura.

Çdo interpretim tjetër që behet për këtë qeshje është interpretim jo profesional, i gabuar, tendencioz, diskriminues dhe favorizues.

Gjate 26 viteve të zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit publik në Kosovë, nuk ka ndodhur që ndonjë Autoritet Kontraktues të ketë kërkuar dhe kamufluar një kriter të tillë, ashtu siç e ka bere AK – Policia e Kosovës gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit. Këtë e dëshmon vete fakti së nga gjithsejte tete (8) oferta të pranuar, vetëm Grupi i OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K dhe Inxhinieret e këtij Grupi të OE e ditën që duhet me vulosur Vendimin për caktimin e inxhinierëve nga të dy palët. Ky fakt na bene që të konsiderojmë që ky kriter për vulosjen e vendimeve nga inxhinieret është vendosur i kamufluar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për Kontrate për ta favorizuar OE të preferuar nga AK- Grupin e OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K.

Gjithashtu eliminimi mi i kompanisë tone - Grupit të OE; OLTİ TRASİNG SH.P.K & UNİCRON SH.P.K; ku ne një ane AK konstaton së ka gabime aritmetikore në Listën e Çmimeve e në anën tjetër këto gabime nuk i konsideron gabim aritmetikore, se gjeja Pozicioni 23 +24 bëjnë 353.20 euro dhe jo 322.00 euro është vendim joprofesional, tendencioz dhe në kundërshtim të plote me legjislacionin e prokurimit publik.

Bazuar ne nenin 59 paragrafi 3 te LPP dhe nenit 40 paragrafi 40.9 te RRPP 002/2024 kjo mos përputhje është **gabim aritmetikor** dhe është dashur të korrigjohet nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave për faktin se vlera **322.00 euro** që është shënuar ne Listën e çmimeve që kemi dorëzuar për artikullin 25 nuk është **çmim për njësi** por është vlerë që është kalkuluar nga **sasitë** dhe **çmimet për njësi** të artikullit 23 dhe artikullit 24 e që është **30 %** e vlerës së artikujve 23 dhe 24.

Çdo interpretim tjetër të këtij gabimi aritmetikor kush do që e bene, është **spekulim dhe behet për qëllime të përfitimeve dhe dëmtim të buxhetit të qytetareve të Republikës së Kosovës.**

Pretendimet Ankimore lidhur me Ofertën e Grupi i OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K që AK ka shpërblyer me kontrate – shkelje e nenit 7 dhe 59 të LPP si dhe shkelje e nenit 40 të RRPP Nr.002/2024

Autoriteti Kontraktues- Policia e Kosovës vendimin për shpërblym me kontrate të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K në vlerë prej **2,020,202.00 €** që është **116,903.57 €** me e lartë së oferta e jone- Grupit të OE; OLTİ TRASİNG SH.P.K & UNİCRON SH.P.K, është bërë në kundërshtim të plotë me nenin 7 dhe 59 të LPP si dhe nenit 40 të RRPP Nr. 002/2024

Arsyeja së pse ne konsiderojmë kështu janë:

Në faqen 28 të Aneksit 7 të Dosjes së Tenderit - Deklarata për Themelimin të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K ku shënon:

Emri dhe Mbiemri (Përfaqësuesi i autorizuar) – shënon - Bege Krasniqi

Data/Nënshkrimi/Vula, është shënuar data 02.06.2026 dhe është nënshkruar por mungon vula e Liderit të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K.

Mos vulosja në këtë pjesë të **Aneksit 7 të Dosjes së Tenderit - Deklarata për Themelimin të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K, automatikisht këtë Marrëveshje të Themelimit të Grupit e bënë jo valide dhe ofertën e Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K në tërësi e bënë oferte të pa përgjegjshme.**

Këtë pretendim ankimor AK-Policia e Kosovës fare nuk e ka trajtuar gjatë shqyrtimit të Kërkesës tone për Rishqyrtim në Vendimin e datës 31.08.2026 për refuzim si të pa bazuar të Kërkesës tone për Rishqyrtim. Mos trajtimi i këtij pretendimi ankimor dëshmon se Zyrtaret e AK-Policisë së Kosovës qëllimisht nuk e kanë trajtuar për faktin se shumë mirë e kanë ditur se mos vulosja e Deklaratës së Themelimit të Grupit në pasusin e fundit të faqes 28 të Aneksit 7 të Dosjes së Tenderit, **Marrëveshjen e Themelimit të Grupit e bënë jo valide dhe ofertën e Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K në tërësi e bënë oferte të pa përgjegjshme** dhe nuk kanë dashur që këtë ta shpalosin në Vendimin për Refuzim të Kërkesave për Rishqyrtim të datës 31.08.2026.

Dëshmi: Aneksi 7- Deklarata për Themelim të Grupit të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K

Nëse mungesa e vulosjes së Vendimit për caktimin e Inxhinierëve (që kanë statusin e personit fizik) ofertën tone dhe **5 oferta tjera të OE tjerë**, Autoriteti Kontraktues i ka konsideruar si të pa përgjegjshme, atëherë si ka mundësi që AK mungesën e vulës së Liderit në Deklaratën për Themelimin e Grupit të mos e vërejë dhe ofertën e Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K të konsideroj si oferte të përgjegjshme dhe ta shpërblejë me kontrate më çmim shumë me të lartë se të ofertës tone dhe ofertat e OE tjerë që i ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit.

Prandaj ky trajtim jo i barabarte i Operatoreve Ekonomik nga ana Zyrtareve të AK-Policisë së Kosovës gjate vlerësimit të ofertave është shkelje esenciale e nenit 7 të LPP.

Nga dokumentet që kemi pranuar në CD nga Autoriteti Kontraktues, kemi vërejte së AK në Deklaratën nen Betim të Liderit të grupit, OE: CONSTRUMAX SH.P.K dhe Deklaratën nen Betim të anëtarit të grupit, OE: HARST Group SH.P.K, Aneksit 3- Kërkesa për Sekret Afarist e Liderit të grupit, OE: CONSTRUMAX SH.P.K dhe Aneksit 3- Kërkesa për Sekret Afarist e anëtarit të grupit, OE: HARST Group SH.P.K si dhe Aneksin 7- Marrëveshjen e Themelimit të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K Zyrtaret e AK-Policisë së Kosovës i kane mbuluar me të zeze numrin e aktivitetit të prokurimit .

Dëshmi: - Deklarata nen Betim e Liderit të grupit, OE: CONSTRUMAX SH.P.K

Dëshmi: Deklarata nen Betim e anëtarit të grupit, OE: HARST Group SH.P.K

Dëshmi: Aneksit 3- Kërkesa për Sekret Afarist e Liderit të grupit, OE: CONSTRUMAX SH.P.K

Dëshmi: Aneksit 3- Kërkesa për Sekret Afarist e anëtarit të grupit, OE: HARST Group SH.P.K

Dëshmi: Aneksin 7- Marrëveshjen e Themelimit të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K.

Nisur nga fakti që është here e trete që zhvillohen procedurat e prokurimit për këtë projekt na bene të dyshojmë së këtë veprim Zyrtaret e AK e kane bere me qellim të fshehjes së ndonjë gabimi të mundshëm të bere nga OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K në shënimin e numrit të aktivitetit të prokurimit ne këto dokumente.

Megjithatë i mbetet Ekspertit Shqyrtues dhe Panelit Shqyrtues që këto dyshime tona ti verifikojnë në dokumentet e origjinalit të ofertës të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K.

Gjithashtu aty ku të dhënat kane qene të dukshme kemi analizuar edhe kontratat e punës dhe dokumentet tjera të Inxhinierëve që ky grup i OE i ka dërguar të AK së bashku me ofertën dhe kemi konstatuar së mbi 80 % e këtyre kontratave janë dokumente të hartuara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi që rregullon mardhenjën e punës dhe legjislacionin që rregullojnë pagesën e tatimeve dhe kontributeve në paga si dhe caktimin e pagës minimale.

Inxhinieret që janë caktuar me Vendim nga Grupi i OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K, për këtë projekt të cilët kane kontrate dy vjeçare , kane nënshkruar dhe vulosur Vendimin mbi caktimin në këtë projekt kane këto paga:

V.E – sipas vendimit për këtë projekt është caktuar Inxhinier Përgjegjës për Arkitekturë , sipas kontratës punon 4 ore në dite dhe 20 ore në jave. Pagën bruto mujore sipas kontratës e ka **250.00 €**

E.Sh. – sipas vendimit për këtë projekt është caktuar Inxhinier Përgjegjës për Elektroteknike – Energjetike , sipas kontratës -orare jo i plote i punës 20 ore në jave. Pagën bruto mujore sipas kontratës e ka **200.00 €**

S.N. – sipas vendimit për këtë projekt është caktuar Inxhinier Përgjegjës për Elektroteknike – Elektronike , sipas kontratës punon 4 ore në dite dhe 20 ore në jave. Pagën bruto mujore sipas kontratës e ka **120.00 €**

S.G. – sipas vendimit për këtë projekt është caktuar Inxhinier Përgjegjës për Ndërtimtari , sipas kontratës punon 4 ore në dite dhe 20 ore në jave. Pagën bruto mujore sipas kontratës e ka **820.00 €** .

A.L. – sipas vendimit për këtë projekt është caktuar Inxhinier Përgjegjës për Hidroteknike dhe Mbrojtje nga Zjarri , sipas kontratës punon 4 ore në dite dhe 20 në jave. Pagën bruto mujore sipas kontratës e ka **200.00 €** .

SH.A. – sipas vendimit për këtë projekt është caktuar Inxhinier Përgjegjës për Makineri , sipas kontratës punon orar jo i plote i punës, 20 ore në jave. Pagën bruto mujore sipas kontratës e ka **150.00 €** .

V.G – sipas vendimit për këtë projekt është caktuar Inxhinier Përgjegjës për Mbrojtje te Ambientit , sipas kontratës punon orar jo i plote i punës, 20 ore në jave. Pagën bruto mujore sipas kontratës e ka **120.00 €** .

F.B. – sipas vendimit për këtë projekt është caktuar Inxhinier Përgjegjës për Gjeodezi , sipas kontratës punon orar jo i plote i punës, 20 ore në jave. Pagën bruto mujore sipas kontratës e ka **300.00 €** .

B.R. – sipas vendimit për këtë projekt është caktuar Inxhinier Përgjegjës -Menaxher i Kontratës , sipas kontratës punon me orar të plote të punës, 40 ore në jave. Pagën bruto mujore sipas kontratës nuk shihet së e kane mbuluar me ngjyre të zeze Zyrtaret e AK -Policisë se Kosovës.

Ku kemi analizuar pagat e stafit teknik me shkolla të mërsemë dhe stafin që ka ndjekur trajnime për zanate të ndryshme, saldues, armirues, kranist, latues, etj , kemi konstatuar së paga e Inxhinierëve që janë Caktuar me Vendim e të cilët **kane marre përgjegjësi për mbikëqyrjen dhe realizimin e projektit janë deri ne katër here me të ulëta së të stafit teknik.** Gjithashtu bazuar në CV e Inxhinierëve që jane caktuar me vendim dhe kane marre përgjegjësi për realizimin e projektit, kane të krijuar marrëdhënie pune edhe me kopani private tjera (ka raste deri ne katër kompani) e ka raste edhe me Kopani Publike dhe Institucione Shtetërore të Republikës se Kosovës ku orarin e punës e kane 8 ore ne dite dhe 5 dite ne jave prandaj shtrohet pyetja së si do të realizojnë përgjegjësitë qe i kane marre në baze të vendimeve qe i kane nënshkruar dhe vulosur të dy palët. apo është vetëm blerje e letrave nga këta Inxhinierë për këtë aktivitet të prokurimit?

Dëshmi – Kontratat e Inxhinierëve që janë caktuar sipas vendimeve dhe kontratat e një pjese të stafit teknik-punëtorëve.

Të gjitha këto fakte dhe argumente që i shpalosëm me larte dëshmojnë së Oferta e Grupi i OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K është oferte e pa përgjegjshme dhe Autoriteti Kontraktues vlerësimin e ofertave dhe vendimin për shpërbllim me kontrate e kanë bërë në kundërshtim të plotë me dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik të shënuara me larte në këtë ankesë.

Bazuar në të gjitha këto që i cekem me larte dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të cekura me larte, kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues i OSHP –së, që të gjitha këto fakte dhe pretendime të verifikoj në ofertën e Grupi i OE: CONSTRUMAX SH.P.K; HARST Group SH.P.K.

Gjithashtu kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që Ankesën tonë ta konsiderojë si të bazuar dhe lenden ta kthejë në Ri-vlerësim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes së Ofertës shume voluminozë, Shpezimet e sigurimit të tenderit, shpenzimet përgatitjes së Kërkesës për Ri shqyrtim, shpenzimet e përgatitjes së Ankesës për OSHP dhe fitimet e pritura.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. B05- Njoftimi për kontrate: 13.04.2026
2. B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara: 27.04.2026
3. B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara: 11.05.2026
4. B54- Formulari Standard për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara: 21.05.2026
5. Dosja e Tenderit: 08.04.2026
6. Dosja e Tenderit: 24.04.2026
7. Dosja e Tenderit: 08.05.2026
8. Dosja e Tenderit: 20.05.2026
9. Kërkesë për Rishqyrtim në kriteret e DT: Nuk ka date të shënuar në Vendim e AK kur është dorëzuar Kërkesa për Rishqyrtim.
10. Vendim për Pezullim të aktivitetit të prokurimit: 16.04.2026
11. Vendim për aprovim të pjesshëm e Kërkesës për Rishqyrtim: 24.04.2026
12. Kërkesë për Rishqyrtim në kriteret e DT: Nuk ka date të shënuar në Vendim e AK kur është dorëzuar Kërkesa për Rishqyrtim.
13. Vendim për Pezullim të aktivitetit të prokurimit: 30.04.2026
14. Vendim për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim: 05.05.2026

15. Kërkesë për Rishqyrtim ne kriteret e DT: Nuk ka da te të shënuar ne Vendim e AK kur është dorëzuar Kërkesa për Rishqyrtim.
16. Vendim për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim:20.05.2026
17. Ankesa në OSHP nr.354/26: 02.06.2026
18. Procesverbal i Hapjes së Tendereve:02.06.2026
19. Vendimi i OSHP-se- PSH.NR 354/26- 08.06.2026
20. B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues:18.08.2026
21. Kërkese për Rishqyrtim Olti Trasing SH.P.K: 24.08.2026
22. Vendim mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit:25.08.2026
23. Vendimi i AK - Refuzim i Kërkesës për Rishqyrtim : 31.08.2026Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 te LPP-së;

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*



PËR: AUTORITETIN KONTRAKTUES – POLICIA E KOSOVËS

NGA : OPERTATORI EKONOMIK – OLTİ TRASİNG SH.P.K - PRİSHİTİNË

LËNDA: KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTET E TENDERIT

DATA: 19.08.2026

Bazuar në **nenit 10, paragrafi 3 të LPP**, si pale e interesit që kemi ofertuar, kërkojmë qasje në dokumentet e tenderit për aktivitetin me numër të prokurimit: **214/30400-26-1946-5-1-1-NDËRTIMI I STACIONIT POLICOR VERI NË PRISHTINË**

Kërkesa për qasje në dokumentet e tenderit ka të beje konkretisht me dokumentet:

- Ofertën e OE që AK ka shpërblyer me kontrate- Grupi i OE: **CONSTRUMAX SH.P.K & HARST Group SH.P.K, Suharekë.**
- Raportin e Vlerësimit të Ofertave.

Për shkak të afatit shume të shkurte te përgatitjes së Kërkeses për Rishqyrtim ju lutem qasja të na lejohet në afat sa me të shkurtër të mundshëm, por jo më vonë se nesër me datën **20.08.2026** ora **10:00**.

Më Respekt

“Olti Trasing“ Sh.p.k





PËR: AUTORITETIN KONTRAKTUES – POLICIA E KOSOVËS

NGA : OPERTATORI EKONOMIK – OLTİ TRASİNG SH.P.K - PRİSHTİNË

LËNDA: KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTET E TENDERIT

DATA: 20.08.2026

Bazuar në **nenit 10, paragrafi 3 të LPP**, si pale e interesit që kemi ofertuar, **kërkojmë prape** qasje në dokumentet e tenderit për aktivitetin me numër të prokurimit: **214/30400-26-1946-5-1-1- NDËRTIMI I STACIONIT POLICOR VERI NË PRISHTINË.**

Arsyeja së pse ne kërkojmë prape qasje në dokumentet e tenderit është fakti së dje me datën **19.08.2026** kur përfaqësueseje e kompanisë tone ka qene në qasje, Zyrtaret e Autoritetit Kontraktues nuk ja kane dhënë as në kopje të forte e as në mënyre elektronike (CD) këto dokumente të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K & HARST që Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar që të shpërblehet me kontrate:

Certifikata ISO 9001 2015,

Certifikata ISO 14001 2015

Certifikata ISO 3834-3 2008 apo ISO 3834-3 2005 (për saldim)

Këto ISO Certifikata, përfaqësueses të kompanisë tone, Zyrtarët e AK i kane lejuar që ti shikoj vetëm vizualisht në kompjuterin e zyrtares së AK me arsyetimin së janë konsideruar konfidenciale.

Ky veprim i Zyrtareve të AK , **është shkelje esenciale e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik** , për faktin së Autoriteti Kontraktues këto ISO Certifikata i ka kërkuar në Dosjen e Tenderit të FDT – Neni 7.1&7.2- **Përshtatshmëria profesionale** dhe Njoftimin për Kontrate i ka kërkuar të **III.2.2) Përshtatshmëria profesionale.**

Kërkesat e Përshtatshmërisë Profesionale janë të rregulluara me nenin **66 të LPP** dhe nenin **25 të RRPP Nr.002/2024** si dhe nenit **8 të UDHËZUESIT NR. 002/2024** dhe asnjë nga dokumentet – dëshmitë që kërkohen të Kërkesat e Përshtatshmërisë Profesionale nuk mund të konsiderohen konfidenciale.

Bazuar në nenin **11 paragrafi 3 të LPP** si konfidenciale mund të konsiderohen vetëm disa nga dokumentet që janë kërkuar sipas kërkesave të Kapaciteteve Ekonomike dhe Financiare - **neni 68 i LPP** dhe Kapaciteteve Teknike dhe Profesionale - **neni 69 i LPP.**

Përshkrim i nenit 11 paragrafi 3 i LPP

3. Autoriteti kontraktues mund t'i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere:

- 3.1 që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas **nenit 68 ose 69 të këtij ligji**;
- 3.2. që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t'i mbajë artikuljt e tillë si sekret; dhe
- 3.3 kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operator ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.

Përshkrim i nenit 7 paragrafi 7.5 pika a dhe b, paragrafi 7.6, pika a dhe b dhe paragrafi 7.6.5

7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë:

- a. informacionet në lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se; dhe
- b. informacionet në lidhje me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP-se

7.6 Informacionet mund të klasifikohen si konfidenciale vetëm nëse:

- a. Operatori Ekonomik, përveç se i identifikon ("markon") dokumentet si "sekret afarist" gjatë ngarkimit të tyre në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, i njëjti duhet të plotësojë Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit "*Kërkesa për sekret afarist*".
- b. Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi *Aneksin 3 "Kërkesa për sekret afarist"*, të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të identifikuar si "sekret afarist", nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij.

7.6.5 Jo të gjitha dokumentet e specifikuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë në përputhje me nenin 68 dhe 69 të LPP-së, mund të klasifikohen si informata sekrete afariste. Dokumentet e specifikuara sipas nenit 68 e 69 të LPP e të cilat janë publike në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit tjetër përkatës në fuqi, nuk mund të klasifikohen si informata sekrete afariste.

Bazuar në këto dëshmi dhe fakte të shënuara më lartë shihet së këto ISO Certifikata janë kërkuar të Kërkesat e Përshtatshmërisë Profesionale dhe **në asnjë mënyrë Autoriteti Kontraktues nuk mund ti konsideroj si konfidenciale** dhe mos të na lejoj qasje të plote në këto dokumente pa marre parasysh së çka ka kërkuar Grupi i OE: CONSTRUMAX SH.P.K & HARST.

Prandaj prape kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues -Policia e Kosovës që të na lejoj qasje te plote duke na jep ne menyre elektronike -CD , ISO Certifikatave që Grupi i OE: CONSTRUMAX SH.P.K & HARST ka dorëzuar te AK.

Për shkak të afatit shume të shkurte te përgatitjes së Kërkesës për Rishqyrtim ju lutem qasja të na lejohet sot me datën **20.08.2026** para orës **15:00**, ose ISO Certifikatat e Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K & HARST të na i dërgoj ne mënyre elektronike ne e-mail adresën: prokurimi.oltitrasing@gmail.com

Çdo mos lejim të kompanisë tone në qasjen e ISO Certifikatave të Grupit të OE: CONSTRUMAX SH.P.K & HARST, e konsiderojmë tendencë për mohim të drejtës tone ligjore për të pasur qasje të plote në këto dokumente dhe tendencë për fshehje të dëshmive dhe provave.

Më Respekt

“Olti Trasing “ Sh.p.k



Aneksi 7 DEKLARATA PËR THEMELIM TË GRUPIT

Të nënshkruhet nga secili anëtarë i grupit apo konzorciumi që aplikon

Për: [POLICIA E KOSOVËS]
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: [Construmax SH.P.K & HARST Group SH.P.K]
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: [NDËRTIMI I STACIONIT POLICOR VERI NË PRISHTINË]


Numri i Prokurimit: [214/30400-26-1946-5-1-1]

Hyjnë në bashkëpunim si Grup i Operatoreve Ekonomik , për qëllim të këtij tenderi me titull:
[NDËRTIMI I STACIONIT POLICOR VERI NË PRISHTINË] me numër të prokurimit [214/30400-26-1946-5-1-1].

Ne, Grupi i Operatoreve Ekonomik në përbërje të anëtarëve të grupit:

I. [Construmax SH.P.K]
Shëno emrin e anëtarit të grupit - Liderit

Rr.Mentor Krasniqi p.n. Bukosh -Suharekë
Shëno adresën



dhe

II. [HARST Group SH.P.K]
Shëno emrin e anëtarit të grupit

Rr.7 Marsi p.n -Suharekë
Shëno adresën



shto sipas nevojës

Date: [02/06/2026]

Vendi: [Suharekë]

Anëtarët e grupit lidhim këtë marrëveshje me të cilën deklarojmë:

- f. **Ne të gjithë** anëtarët e grupit jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.
- g. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe se nuk jemi duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

h. Ne të gjithë anëtarët e grupit e autorizojmë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe ai është: Construmax SH.P.K

i. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë se jemi të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të FDT-së.

j. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe deklarojmë se % (përqindjen) e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratës është:

- a) Shëno 90% (përqindjen) e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratës se Liderit Construmax SH.P.K]
b) [Shëno 10% (përqindjen) e pjesëmarrjes ne realizimin e kontratës e anëtarit Harst Group sh.p.k]
Shto sipas nevojës

k. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë përgjegjësitë e secilit anëtar:

- a) [Shëno përgjegjësitë e Liderit Liderit Construmax SH.P.K- Të gjitha përgjegjësitë që rrjedhin nga realizimi i projektit dhe ato që i takojnë liderit të grupit, përfshirë: Menaxhimin dhe udhëheqjen profesionale, në përputhje me përqindjen e përcaktuar më sipër, të punimeve ndërtimore, arkitektonike, instalimeve elektrike, makinerike dhe hidroteknike, si dhe të punimeve të tjera të parapara në projekt dhe në ofertë]
b) [Shëno përgjegjësitë e anëtarit HARST Group shpk- Të gjitha përgjegjësitë që rrjedhin nga realizimi i projektit dhe ato që i takojnë anëtarit të grupit, përfshirë: Menaxhimin dhe udhëheqjen profesionale, në përputhje me përqindjen e përcaktuar më sipër, të punimeve ndërtimore, arkitektonike, instalimeve elektrike, makinerike dhe hidroteknike, si dhe të punimeve të tjera të parapara në projekt dhe në ofertë]

Shto sipas nevojës


l. Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë se në rast të shfrytëzimit të drejtës për ankesë si parashihet në nenet 108A dhe 109 të LPP-së, të drejtën për të dorëzuar kërkesën për rishqyrtim/ankesën e ka vetëm lideri i grupit të OE.

m. Ne të gjithë anëtarët e grupit pranojmë që: nëse një anëtar i grupit tërhiqet pas dorëzimit të tenderit (gjatë fazës së vlerësimit), Autoriteti Kontraktues të vazhdojë me anëtarin e mbetur, nëse anëtar i mbetur i plotëson kushtet e parapara në Dosje të Tenderit. Po ashtu ne pranojmë që në këtë rast ndaj anëtarit i cili tërhiqet nga grupi, Autoriteti Kontraktues të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.

Emri i Operatorit Ekonomik (lider) Construmax SH.P.K

Emri Mbiemri Bege Krasniqi

Data/ Nënshkrimi/ Vula 02.06.2026



Anëtarët e tjerë të grupit:

Emri i Operatorit Ekonomik (anëtar) HARST Group SH.P.K

Emri Mbiemri Sadik Ramadani

Data/ Nënshkrimi/ Vula 02.06.2026



Shto sipas nevojës

Emri Mbiemri (Përfaqësuesi i autorizuar) Bege Krasniqi

Data/Nënshkrimi / Vula 02.06.2026



Mungon vula


Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [Construmax SH.P.K] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësive të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	Construmax SH.P.K
Adresa e plotë:	Rr.Mentor Krasniqi p.n. Bukosh-Suharekë
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Bege Krasniqi
Pozita:	Menaxhere
Nënshkrimi:	
Data:	02.06.2026
Vula:	




Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [HARST Group SH.P.K] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedure të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësive të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	Harst Group SH.P.K
Adresa e plotë:	Rr.7 Marsi p.n -Suharekë
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Sadik Ramadani
Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:	
Data:	02.06.2026
Vula:	

Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: **POLICIA E KOSOVËS**
(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE [Construmax SH.P.K] (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

*Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara:
Gjendja ekonomike dhe Financiare: Raporti nga banka dhe ATK, Pasqyrat financiare të audituara*

Aftësia teknike dhe Profesionale

Lista e projekteve (referencat, pranime teknike dhe kontrata), staf teknik profesional


DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyt vijuese:

Deklaratë mbi natyrën e dëmit të tillë material dhe arsyt pse do të duhej të shfaqet: Të dhënat e sipërcekura si sekret afariste janë të bazuara në nenet përkatëse të Ligjit Nr.04/L 042 PER PROKURIMIN PUBLIK TE REPUBLIKES SE KOSOVES, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin NR.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që Autoriteti Kontraktues t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i Kompanisë:	Construmax SH.P.K
Adresa e plotë:	Rr.Mentor Krasniqi p.n. Bukosh-Suharekë
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Bege Krasniqi
Pozita:	Menaxhere
Nënshkrimi:	
Data:	02.06.2026
Vula:	



Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: **POLICIA E KOSOVËS**
(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE [HARST Group SH.P.K] (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

*Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara:
Gjendja ekonomike dhe Financiare: Raporti nga banka dhe ATK, Pasqyrat financiare të audituara*

Aftësia teknike dhe Profesionale

Lista e projekteve (referencat, pranime teknike dhe kontrata), staf teknik profesional

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

Deklaratë mbi natyrën e dëmit të tillë material dhe arsyet pse do të duhej të shfaqet. Të dhënat e sipërcekura si sekret afariste janë të bazuara në nenet përkatëse të Ligjit Nr.04/L 042 PER PROKURIMIN PUBLIK TE REPUBLIKES SE KOSOVES, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin NR.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që Autoriteti Kontraktues t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i Kompanisë:	Harst Group SH.P.K
Adresa e plotë:	Rr.7 Marsi p.n -Suharekë
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Sadik Ramadani
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	02.06.2026
Vula:	

